



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

101/.....Prot.  
17

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

**PROGRAMET E ARSIMIT BAZË**

(Për klasat e shansit të dytë)

**LËNDA: EDUKIM MUZIKOR**

**KLASA I-V**

Tiranë

Dhjetor 2013

Edukimi muzikor në ciklin e arsimit fillor 1- 5, për nxënësit e Shansit të Dytë, zhvillohet pa asnjë ndryshim nga programi ekzistues. Elementet e para të edukatës muzikore fëmija fillon t'i marrë në familje që në moshë të hershme. Më pas, në arsimin parashkollor, përmes këngëve të thjeshta, imitimeve të ritmeve apo të tingujve të ndryshëm nga jeta e përditshme dhe lojërave muzikore, kalohet në një punë të organizuar për t'i pajisur fëmijët me elemente muzikore dhe për t'i përjetuar ato. Të gjithë këto elemente muzikore, të cilat ndërthuren gjatë të kënduarit, të dëgjuarit, të shprehurit të muzikës, janë forma fillestare të të kuptuarit të saj, të cilat do të vijojnë të zhvillohen më tej në arsimin fillor dhe më tej.

Elementet bazë të muzikës jepen në një mënyrë shumë të thjeshtë, duke i marrë dhe konkretizuar ato kryesisht nga jeta e përditshme, nga dëgjimet e thjeshta muzikore, nga të kënduarit e vazhdueshëm, nëpërmjet këngëve për fëmijë apo këngëve popullore të thjeshta. Në këtë mënyrë nxënësit do të aftësohen për të praktikuar elementet muzikore, përmes një gjuhe të thjeshtë dhe të kuptueshme për këtë moshë.

Njohuritë dhe elementet e para muzikore merren dhe mësohen në fillim në mënyrë intuitive, duke i gjetur në mjedisin e tyre ose në klasë dhe duke i zbatuar ato te këngët, lojërat, dëgjimet e ndryshme dhe më pas duke krijuar vetë me to, por edhe gjatë procesit mësimor. Këto njohuri kanë të bëjnë me 1) *shprehitë e të kënduarit* ku ai ai do të fillojë të bëjë shprehi në çdo orë që këndon, *shqiptimi i saktë* i fjalëve të këngës etj; 2) *ritmi*; 3) *vetitë e tingullit* (gjatësia, lartësia, ngjyra, timbri, temp'i etj.); 4) *njohja e veglave ritmike* me goditje dhe përdorimi i tyre gjatë këndimit apo lojërave muzikore; 5) *përjetimi i muzikës dhe shprehja e saj*, duke përdorur mjete të arteve të tjera dhe një terminologji që përputhet me këtë moshë. Pra, gjatë procesit të të mësuarit njohuritë muzikore janë të lidhura ngushtë dhe gjejnë zbatim në praktikën muzikore. Kjo do të thotë se të gjitha njohuritë, aftësitë dhe shprehitë e fituara gjatë procesit mësimor realizohen duke u ndërthurur përmes veprimtarive praktike artistike në klasë, shkollë ose në auditore të ndryshme.

## **SYNIMI I LËNDËS**

Programi synon të zhvillojë shprehitë fillestare për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar, si dhe për t'u shprehur duke vlerësuar muzikën.

## **Objektivat**

Mësimi i muzikës ka për qëllim që nxënësit në fund të klasës së pestë:

- Të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë dhe këngë popullore të thjeshta nga krahina e tyre;
- Të formojnë shprehitë e të kënduarit;
- Të këndojnë me intonacion dhe shprehje;
- Të këndojnë dhe luajnë lojëra muzikore;
- Të shoqërojnë këngët apo lojërat muzikore me mjete të thjeshta ritmike, si: gurë, shkopinj, shuplaka etj;
- Të kuptojnë konceptet muzikore, nëpërmjet shembujve të thjeshtë nga jeta e përditshme dhe muzika që këndojnë dhe dëgjojnë;
- Të gjejnë dhe të kuptojnë ritmin në mjedisin e tyre dhe në muzikë;
- Të dallojnë vetitë e tingullit në këngë ose në pjesë të thjeshta muzikore;
- Të kuptojnë ritmet e thjeshta nëpërmjet lojërave të ndryshme;
- Të dëgjojnë pjesë muzikore, duke përcaktuar karakterin e pjesëve me fjalë të thjeshta (kjo muzikë është e gëzuar sepse më bën të vallëzoj etj.);
- Të shpjegojnë prirjet e tyre muzikore me një gjuhë të thjeshtë për këtë nivel, si dhe me mjete të arteve të tjera.

## **LINJAT E PROGRAMIT**

Programi i Edukimit muzikor, për klasat e Shansit të Dytë, të arsimit fillor është i organizuar në bazë të 5 linjave të cilat zbërthehen si më poshtë:

1. Këndimi,
2. Bazat e arsimimit muzikor,
3. Luajtja në instrument,
4. Dëgjim muzikor,
5. Të shprehurit dhe krijimi muzikor.

## **METODOLOGJIA**

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhen, në përputhje me veçoritë e moshës së nxënësve, të përmbajtjes së temave të ndryshme mësimore apo të bazës materiale

mësimore që mësuesi ka në përdorim. Shumë e rëndësishme është që, përdoruesit e këtij programi të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë nxënësit për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë, shprehitë, prirjet dhe vlerat e tyre muzikore më tej.

Ky program mundëson zhvillimin e modeleve të ndryshme ritmike dhe i drejton nxënësit në përjetimin e kohës 2/4, 3/4, 4/4, përmes veprimtarive konkrete, në mënyrë individuale dhe në grup. Nën drejtimin e përdoruesve të këtij programi, nxënësit në këtë nivel rikujtojnë dhe përvetësojnë më tej njohuri dhe elemente të reja muzikore, duke zhvilluar kështu aftësitë *për të kënduar, për të dëgjuar apo për t'u shprehur*, si dhe për të bërë një analizë të këngëve apo të pjesëve muzikore. Niveli i dijeve dhe shprehive të nxënësit, përcaktohet jo vetëm nga përmbajtja e lëndës, por edhe nga zbatimi i udhëzimeve e kërkesave të veçanta që ka çdo klasë.

Edhe në këtë klasë do të mësohen këngë në përshtatje me moshën për nga shtrirja (ambitusi) do-do dhe nga përmbajtja, me vlera didaktike, të karakterit fëmijor (natyrën, familjen, shkollën, punën, argëtimin etj.) me ritme të larmishme (vallëzuese, marshe, të thjeshta) dhe të krahinës.

Lënda e edukimit muzikor duhet të përqendrohet te:

***Edukimi i ndjenjës ritmike të nxënësve.*** Dukuritë ritmike përjetojnë në formë konkrete nga mjedisi dhe më pas arrihet zbatimi i tyre praktik. Mësuesit rikujtojnë njohuritë e marra rreth ritmit, duke sjellë në klasë modele të thjeshta ritmike (2/4, 3/4, 4/4) dhe duke i zhvilluar ato me nxënësit. Gërshetimi i ushtrimeve me ritmet e thjeshta në shoqërimin e këngëve është i domosdoshëm.

***Edukimi i ndjenjës melodike.*** Mësuesit zhvillojnë ndjenjën melodike tek nxënësit, përmes të kënduarit të këngëve, shembujve të thjeshtë melodikë, ose përmes dëgjimit muzikor.

***Edukimi i shprehive të të kënduarit*** shikohet i pandarë nga *aftësitë* dhe *shprehitë* e tjera në edukimin muzikor. Mësuesit punojnë për të zhvilluar shprehitë e të kënduarit përmes:

- rikujtimit të kërkesave gjatë të kënduarit,
- zhvillimit të ndjenjës ritmike saktë,
- intonimit të saktë të këngëve apo pjesëve muzikore.

***Edukimi me instrumentet dhe marrëdhëniet me to.*** Shoqërimi i këngëve apo pjesëve të ndryshme muzikore me instrumente me goditje dhe ORF, bën që këto instrumente të krijojnë lidhje të afërta me artin muzikor dhe zhvillojnë njëkohësisht ndjenjën ritmike të nxënësve. Instrumentet ORF melodike apo ritmike, shtojnë interesin për lëndën, si dhe i ndihmojnë nxënësit më mirë drejt edukimit të ndjenjës ritmike dhe melodike.

***Edukimi i shprehive gjatë dëgjimit.*** Dëgjimi i këngëve ose pjesëve të thjeshta muzikore, vazhdon të zhvillojë tek nxënësit njohuri më të plota rreth muzikës, duke i edukuar ata me dëshirën për të dëgjuar. Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet të cilit nxënësit vihen në marrëdhënie me muzikën. Nga njohuritë që ata kanë tashmë rreth *ritmit, tingujve, kohëve të thjeshta 2/4, 3/4, 4/4, karakterit*, ata e përjetojnë muzikën jo më në mënyrë spontane, por duke bërë vlerësimin e saj me fjalë të thjeshta.

Mësuesit vazhdojnë punën për kultivimin e ndjenjës së të dëgjuarit të nxënësit, duke përdorur gjithashtu *formën e bisedës*, ku sqarohen dhe shpjegohen karakteri i pjesës, elementet muzikore, si: vetitë e tingullit, ritmin, karakterin etj.; rinjohja e instrumente muzikore përmes dëgjimit, duke dalluar timbrin e tyre, apo edhe njohja me instrumente të tjera muzikore. Gjithashtu, është e domosdoshme që mësuesit të kultivojnë te nxënësit ndjenjën kritike dhe vlerësuese kështu ata mësohen të mbajnë qëndrim, duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

## **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE**

Vlerësimi është një proces, i cili jep një informacion të domosdoshëm e të mjaftueshëm për të verifikuar e për të matur përvetësimin e njohurive dhe të shprehive nga nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë bëhet përmes përfundimeve që arrin nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup nga veprimtaria praktike - artistike, d.m.th. përmes *të kënduarit, të luajturit, të dëgjuarit, të analizuarit të pjesëve muzikore* etj. Vlerësimi bëhet në atë ç'ka nxënësi ka përvetësuar dhe është i aftë të bëjë. Gjithashtu, mësuesi do të ketë si udhëzues edhe dokumentin e standardeve të arritjes për këtë lëndë.

## KLASA I-rë

*30 javë x 1 orë = 30 orë*

1. Këndimi & lojëra muzikore	20 orë
2. Bazat e arsimimit muzikor	2 orë
3. Dëgjim muzikor	2 orë
4. Luajtje në instrument	4 orë
5. Shprehje dhe krijim muzikor	2 orë

### PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

#### **LINJA I. Këndimi & lojëra muzikore**                      **20 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike , didaktike dhe të krahinës;
- të demonstrojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si: rregullat e frymëmarrjes, qëndrimi drejt, diksioni, këndimi me ndjenjë etj;
- të shqiptojnë saktë tekstin dhe me intonacion të saktë;
- të këndojnë dhe të interpretojnë në mënyrë shprehëse, duke treguar se e kanë kuptuar tekstin e këngës;
- të këndojnë vetëm dhe në grup;
- të krijojnë efekte të veçanta tingujsh (imitimi i zërave të shokëve, të instrumenteve të ndryshme etj.), duke përdorur zërin, shuplakat, shkopinj ose instrumente;
- të përjetojnë ndjenjën ritmike dhe melodike përmes këndimit të këngëve të ndryshme;
- të ndjekin ndryshimet e ritmit (në mjedisin e tyre, në këngë apo pjesë të ndryshme fëminore);
- të shfaqin dëshirat e tyre për këngë të ndryshme (këngë për fëmijë ose të krahinës);
- të luajnë lojëra muzikore, duke i shoqëruar me pëllëmbë ose mjete ritmike (gurë, shkopinj);
- të luajnë lojëra muzikore duke ndërthurur muzikën me lëvizjen;

- të respektojnë mendimin e të tjerëve për këngët.

## **LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor**

**2 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të ndjekin dhe të dallojnë ndjenjën ritmike dhe melodike tek këngët, lojërat, pjesët muzikore;
- të dallojnë tingujt nga zhurmat (i gjejnë ato në jetën e përditshme dhe t'i përcaktojnë);
- të identifikojnë shembuj të ritmit në jetën e përditshme dhe në muzikë *ngadalë – shpejt*, p.sh.: rrahja e zemrës, tik-taku i orës, rrahja e pulsit të dorës, rrahja e daulles në një marsh etj;
- të identifikojnë tinguj të ndryshëm që dëgjon në jetën e përditshme, në mjedisin e klasës dhe në muzikë: zhurma i derës, zëri i zogut, zëri i shokut etj., duke përcaktuar vetitë e tyre (i trashë, i hollë, i butë – i fortë etj.). Pra, tingull:

*( lartësia) i lartë – i ulët,*

*(gjatësia) i gjatë – i shkurtër,*

*(ngjyra) i lehtë - i fortë*

**Tempin**

**Karakterin e një kënge, valleje, pjese muzikore;**

- të krijojnë modele ritmike, duke i imituar shembujt e mësipërm;
- të identifikojnë ritmin në të folur (p.sh., modele të tingujve të gjatë dhe të shkurtër në vargjet e një vjershë).

## **LINJA III. Luajtja me instrument**

**4 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të demonstrojnë modele të thjeshta ritmike: rrahje me pëllëmbë, me vegla, me goditje;
- të shoqërojnë këngën me vegla ritmike apo të krijuara nga ata;

- të shoqërojnë lojërat muzikore me vegla ritmike ose duke i shoqëruar me lëvizjet trupore.

#### **LINJA IV. Dëgjimi muzikor**

**2 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të dallojnë përmes dëgjimit zërat vokalë dhe të veçojnë dy nga karakteristikat e tyre;
- të dallojnë disa instrumente muzikore përmes dëgjimit;
- të komentojnë me fjalët e tyre muzikën që dëgjojnë (shpejt, ngadalë, rëndë, ëmbël);
- të shoqërojnë muzikën, nëpërmjet lëvizjeve të përshtatshme (duke marshuar, duke vallëzuar).

#### **LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor**

**2 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të gjejnë ndryshimet ndërmjet tempit (*shpejt – ngadalë*), duke dhënë shembuj që ndodhin në mjedisin e tyre dhe në muzikë;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që dëgjojnë, përmes gjesteve, mimikës etj.;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që dëgjojnë, përmes formave të ndryshme të artit (vizatimi, tregimi, poezia);
- të listojnë disa fjali, shprehje që përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

#### **KLASA II-të**

**30 javë x 1 orë = 30 orë**

1. Këndimi & lojëra muzikore	20 orë
2. Bazat e arsimimit muzikor	2 orë
3. Dëgjim muzikor	2 orë
4. Luajtje në instrument	4 orë
5. Shprehje dhe krijim muzikor	2 orë



## **PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE**

### **LINJA I. Këndimi & lojëra muzikore 20 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike, didaktike dhe të krahinës;
- të demonstrojnë dhe të zbatojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si:
  - rregullat e frymëmarrjes,
  - qëndrimi drejt,
  - diksioni,
  - këndimi me ndjenjë,
  - shqiptimi i saktë i tekstit etj.;
- të këndojnë me intonacion të saktë;
- të këndojnë solo dhe në grup (ansambël/kor);
- të këndojnë dhe të interpretojnë në mënyrë shprehëse, duke treguar se e kanë kuptuar tekstin e këngës;
- të shfaqin shijet e tyre për këngë të ndryshme (këngë për fëmijë -shqiptare ose të huaja dhe të krahinës);
- të respektojnë mendimin dhe shijet e të tjerëve për këngët që ata zgjedhin;
- të shprehin mendimin rreth muzikës që këndojnë.

#### *Lojëra muzikore*

- të interpretojnë 2 – 3 lojëra muzikore, duke i shoqëruar me vegla ritmike ose ORF, apo duke ndërthurur muzikën me lëvizjet.

### **LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor**

**2 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të zhvillojnë ndjenjën ritmike dhe melodike të këngët, lojërat dhe pjesë të ndryshme muzikore;
- të gjejnë shembuj të ritmit në mjedis dhe në muzikë;

- të përjetojnë ritme të ndryshme tek këngët, lojërat, pjesët muzikore;
- të riprodhojnë tinguj ose zhurma me zë, trup, instrumente;
- të përcaktojnë vetitë e tingullit duke sjellë shembuj nga mjedisi i klasës dhe në muzikë:

*Lartësia:* i lartë – i ulët – më i ulët,

*Gjatësia:* i gjatë – i shkurtër – më i shkurtër,

*Ngjyra:* i lehtë - i fortë – gjysëm fort,

*Timbri:* zërat e burrave, të grave, fëmijëve apo instrumenteve të ndryshme që dëgjon

*Tempi:* ngadalë – shpejt

*Karakteri* në një këngë, valle, pjese muzikore: i gëzueshëm - i qetë – i dhimbshëm;

- të krijojnë modele të thjeshta ritmike;
- të regjistrojnë gjatësi ritmike (p.sh., modele të tingujve të gjatë dhe të shkurtër në vargjet e një vjershe, me grafikë).

### **LINJA III. Luajtja me instrument**

**4 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të krijojnë ritme të ndryshme nëpërmjet instrumenteve me goditje;
- të njohin veglat ORF;
- të shoqërojnë këngën me vegla ritmike ose ORF.

### **LINJA IV. Dëgjimi muzikor**

**2 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të ridallojnë përmes dëgjimit zërat vokalë: të burrave, grave, fëmijëve duke dhënë disa nga karakteristikat e tyre;
- të rinjohin disa instrumente muzikore përmes pamjes dhe dëgjimit: fyelli, çiftelia, lodra;

- të rinjohin pjesë muzikore, nga programi që zhvillohet në klasë si dhe nga ato që transmetohen në TV.

### **LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor**

**2 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vallëzim, vizatim, poezi etj;
- të improvizojnë lëvizje të ndryshme në përshtatje me ritmin dhe melodinë;
- të gjejnë ndryshimet ndërmjet tempit, shpejt – ngadalë, duke dhënë shembuj që ndodhin në mjedisin e tyre dhe në muzikë;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që ata dëgjojnë.
- të listojnë disa veprimtari që zhvillohen në komunitetin e tyre ose në jetën e tyre të përditshme, si: muzika e dëgjuar në televizion, festat familjare, festat apo spektaklet në krahinë apo në vend;
- të listojnë disa fjali, shprehje, që ata përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

### **KLASA III-të**

**30 javë x 1 orë = 30 orë**

1. Këndimi	19 orë
2. Bazat e arsimimit muzikor	3 orë
3. Dëgjim muzikor	2 orë
4. Luajtje në instrument	4 orë
5. Shprehje dhe krijim muzikor	2 orë

### **PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE**

#### **LINJA I. Këndim**

**19 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike, didaktike dhe të krahinës, brenda oktavës do-do<sup>2</sup>;

- të zhvillojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si:
  - rregullat e frymëmarrjes,
  - qëndrimi drejt,
  - diksioni,
  - këndimi me ndjenjë,
  - këndimi me intonacion;
  - shqiptimi i saktë i tekstit etj.;
- të këndojnë dhe të interpretojnë në mënyrë shprehëse, duke treguar se e kanë kuptuar tekstin e këngës;
- të këndojnë solo;
- të këndojnë në grup (ansambël/kor);
- të shfaqin shijet e tyre dhe të shprehin mendimin rreth muzikës që këndojnë, si dhe këngëve të ndryshme (këngë për fëmijë, shqiptare ose të huaja, edhe të krahinës);

## **LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor**

**3 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përjetojnë ritme të thjeshta  $2/4$ ,  $3/4$ ,  $4/4$  tek këngët, lojërat, pjesët muzikore;
- të krijojnë modele të thjeshta ritmike;
- të zbatojnë kohën *e theksuar* e të *patheksuar* në këngë ose melodi;
- të regjistrojnë gjatësi ritmike (p.sh., modele të tingujve të gjatë dhe të shkurtër, të lartë ose të ulët etj., në vargjet e një vjershe, me grafikë).

## **LINJA III. Luajtja me instrument**

**4 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të krijojnë ritme të ndryshme nëpërmjet instrumenteve me goditje;
- të shoqërojnë këngët ose meloditë e ndryshme me instrumente ORF;

#### **LINJA IV. Dëgjimi muzikor**

**2 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përcaktojnë pjesët vokale nga instrumentale duke:
- dalluar disa karakteristika të tyre;
- njohur disa instrumente, si: flaut, trompë, çifteli, ksilofon përmes dëgjimit dhe pamjes;
- të rinjohin pjesë muzikore (këngë për fëmijë, popullore valle etj., nga programi që zhvillohet në klasë, si dhe nga ato që transmetohen në TV apo komunitet).

#### **LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor**

**2 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vallëzim, vizatim, poezi etj.;
- të shpjegojnë me fjalë të thjeshta, ndjenjën që ata provojnë përmes përjetimit të pjesëve me karakter të ndryshëm: të *dhimbshëm*, të *gëzuar*, të *qetë*, *marsh*;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që ata dëgjojnë, duke improvizuar lëvizje të ndryshme në përshtatje me ritmin dhe melodinë;
- të listojnë disa veprimtari që zhvillohen në komunitetin e tyre ose në jetën e tyre të përditshme, si: muzika e dëgjuar në televizion, festat familjare, festat apo spektaklet në krahinë apo në vend;
- të listojnë disa fjali, shprehje, që ata përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

## KLASA IV - ët

30 javë x 1 orë = 30 orë

1. Këndimi	18 orë
2. Bazat e arsimimit muzikor	2 orë
3. Dëgjim muzikor	3 orë
4. Luajtje në instrument	4 orë
5. Shprehje dhe krijim muzikor	3 orë

### PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

#### LINJA I. Këndim

18 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të këndojnë “Himnin e flamurit”;
- të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike, didaktike dhe të krahinës, brenda oktavës do-do<sup>2</sup>;
- të zhvillojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si:
  - qëndrimi drejt,
  - rregullat e frymëmarrjes,
  - diksioni,
  - këndimi me ndjenjë,
  - këndimi me intonacion;
- të këndojnë solo dhe në grup (ansambël/kor);
- të këndojnë dhe të interpretojnë në mënyrë shprehëse;
- të shfaqin shijet e tyre dhe të shprehin mendimin rreth muzikës që këndojnë, si dhe këngëve të ndryshme (këngë për fëmijë, shqiptare ose të huaja, edhe të krahinës).

#### LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor

2 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përjetojnë dhe zhvillojnë ndjenjën ritmike 2/4, 3/4, 4/4 tek këngët, lojërat, pjesët muzikore;

- të ligjërojnë modele ritmike 2/4, 3/4, 4/4;
- të krijojnë modele të thjeshta ritmike në këto kohë me rrahje shuplakash ose goditje shkopinjsh;
- të regjistrojnë gjatësi ritmike (*p.sh., modele të tingujve të gjatë dhe të shkurtër, të lartë ose të ulët etj., me grafikë*).

### **LINJA III. Luajtja me instrument** **4 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të krijojnë ritme të ndryshme nëpërmjet instrumenteve me goditje;
- të shoqërojnë këngët ose meloditë e ndryshme me instrumente ORF.

### **LINJA IV. Dëgjimi muzikor** **3 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të dallojnë pjesët vokale nga instrumentale duke dalluar disa karakteristika të tyre: zërat e njerëzve dhe të instrumenteve të ndryshëm.
- të dëgjojnë pjesë të thjeshta për *piano, kitarë, violinë*, duke i përcaktuar ato përmes dëgjimit.

### **LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor** **3 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vallëzim, vizatim, poezi etj.;
- të shpjegojnë me fjalë të thjeshta, ndjenjën që ata provojnë përmes përjetimit të pjesëve me karakter të ndryshëm: të *dhimbshtëm, të gëzuar, të qetë, marsh*;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që ata dëgjojnë;
- të listojnë disa fjali, shprehje, që ata përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

### **KLASA V - të**

**30 javë x 1 orë = 30 orë**

- |                              |        |
|------------------------------|--------|
| 1. Këndimi                   | 17 orë |
| 2. Bazat e arsimimit muzikor | 3 orë  |

3. Dëgjim muzikor	3 orë
4. Luajtje në instrument	4 orë
5. Shprehje dhe krijim muzikor	3 orë

## PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

### LINJA I. Këndim

17 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të këndojnë saktë “Himnin e flamurit”;
- të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike, didaktike dhe të krahinës, brenda oktavës do-do<sup>2</sup>;
- të zhvillojnë më tej shprehitë vokale gjatë të kënduarit;
- të këndojnë solo;
- të këndojnë në grup (ansambël/kor);
- të këndojnë kanone në kohë të thjeshta;
- të interpretojnë këngët në mënyrë shprehëse, duke respektuar shenjat e ngjyrimit;
- të shprehin mendimin rreth muzikës që këndojnë, ose të këngëve të ndryshme si: (këngë për fëmijë, shqiptare, të huaja dhe të krahinës).

### LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor

3 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të shkruajnë shenjën e notës (forma: koka dhe bishti);
- të shkruajnë saktë shenjën e notës në vija dhe hapësira;
- të ligjërojnë modele ritmike 2/4, 3/4, 4/4;
- të krijojnë modele të thjeshta ritmike 2/4, 3/4, 4/4;
- të përcaktojnë *vetitë e tingullit* (*i ulët – i lartë; i gjatë – i shkurtër; karakterin;*) në një pjesë të thjeshtë muzikore.

### LINJA III. Luajtja me instrument

4 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:



- të ndërtojnë instrumente të thjeshta me goditje, duke ndjekur udhëzimet (*tamburi, triangolo*);
- të krijojnë ritme të ndryshme nëpërmjet instrumenteve me goditje;
- të shoqërojnë këngët ose meloditë e ndryshme me instrumente ORF.

#### **LINJA IV. Dëgjimi muzikor**

**3 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përdorin magnetofonin;
- të dallojnë *shenjat e ngjyrimit (p, mf, f)* në këngët që këndojnë;
- të ekzekutojnë *shenjat e ngjyrimit* gjatë këndimit;
- të njohin disa instrumente ritmike dhe melodike si: *fyellin, çiftelinë, dajren, glockenshpilin*.

#### **LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor**

**3 orë**

Në këtë linjë nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vallëzim, vizatim, poezi etj.;
- të shpjegojnë me fjalë të thjeshta, emocionet e pjesëve me karakter të ndryshëm;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që ata dëgjojnë;
- të krijojnë vargje të tjera mbi një melodi.